

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR EMËRIMIN E KOORDINATORIT KOMUNAL TË PERFORMANCËS DHE ZYRTARËVE KOMUNALË PËR PERFORMANCË PËR FUSHAT E CAKTUARA NË KOMUNËN E LIPJANIT PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2021

Neni 1 Përbërja

I.Me këtë Vendim, **SHEMSI AZEMI**, në pozicionin e punës Shef i sektorit për tatim në pronë, emërohet **Koordinator Komunal për performancë**, ndërsa **zyrtarë komunalë për performancë për fushat e caktuara** emërohen zyrtarët si vijon:

1. **BURIM GASHI** (fushën e shërbimeve publike administrative)
2. **BUKURIJE ZEJNULLAHU** (fushën e transparences komunale dhe fushën e përgjegjshmërisë komunale)
3. **ALBERT MUSTAFA** (fushën për të drejtat e njeriut, shërbime sociale dhe familjare)
4. **RAMIZ GASHI** (fushën e kulturës, rinisë dhe sportit)
5. **HAQIF RRUSTEMI** (fushën e menaxhimit të fatkeqësive)
6. **HANUSHE BERISHA** (fushën e planifikimit hapësinor komunal, fushën e hapësirave publike komunale dhe fushën e mbrojtjes së mjedisit)
7. **FATBARDHA SHURDHIQI** (fushën e infrastrukturës rrugore lokale, fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, fushën e kanalizimit dhe higjienës publike dhe fushën e menaxhimit të mbeturinave)
8. **SALIHE MAREVCI** (fushën e transportit publik komunal dhe fushën e hapësirave për parkim publik)
9. **HASAN LUMA** (fushën e përfaqësimit gjinor)
10. **BRAHIM DURIQI** (fushën e arsimit parauniversitar)
11. **IZER SINANI** (fushën e kujdesit primar shëndetësor)
12. **LINDA SHAHINI** (fushën e integritit dhe zhvillimit)

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kordinatorit Komunal për Performancë

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kordinatorit komunal për performancë janë:

- Bashkërendon punën e përgjithshme në Komunë për administrimin e sistemit për matjen e performancës,
- Propozon listën e zyrtarëve komunal për performancë(zyrtarëve përgjegjës) për miratim nga kryetari i Komunës dhe udhëheqë punën e tyre në procesin e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të të dhënave (MVRDH),
- Harton planin e veprimit dhe organizon takime pune me zyrtarët komunal të performancës (ZKP) për metodologjinë e zbatimit të tij për MVRDH në sistem,
- Monitoron procesin e MVRDH në sistem dhe jep udhëzime profesionale ZKP gjatë MVRDH sipas nevojë,
- Bashkërendon punën sipas, nevojë, me drejtoritë përkatëse nëpërmjet drejtorit të administratës,
- Bën verifikimin e të dhënave të raportuara nga ZKP sipas një orari përkatës gjatë tërë vitit të raportimit dhe deri me 14 shkurt të vitit vijues.
- Përgatitë të dhënat e verifikuara dhe i dërgon për miratim tek kryetari i komunës nëpërmjet drejtorit të administratës deri me 21 janar të vitit vijues për vitin përkatës të raportimit. Në të njëjtën kohë bën verifikimin e të dhënave, nëpërmjet ZKP, nëse kryetari kërkon për shkak të dyshimeve eventuale në saktësinë e tyre,
- Sipas nevojë, bën raportimin e të dhënave të miratuara nga kryetari kur kjo nuk bëhet automatikisht nëpërmjet sistemit,
- Bën arkivimin e të dhënave të miratuara nga kryetari i komunës në kopje fizike në arkivën e komunës apo në arkivën zyrtare të KKP. Një kopje e miratuar nga kryetari i komunës i të dhënave arkivohet në mënyrë automatike nga programi elektronik në bazën e të dhënave në kompjuterin e KKP, të kryetarit të kryetarit të komunës dhe në MAPL- zyrtari përgjegjës për menaxhimin e të dhënave në DPK.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për performancë

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për performancë janë:

- Harton planin për mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave për fushën përkatëse i ngarkuar nga kryetari i komunës , mbi bazën e kërkesave të KKP.
- Mbledhë, verifikon dhe raporton apo futë të dhëna në sistem gjatë tërë vitit të raportimit dhe deri me 20 janar të vitit vijues.
- Kujdeset që para futjes së të dhënave në sitem, ta verifikojë saktësinë e të dhënës duke u bazuar vetëm në burimin zyrtarë të të dhënave përkatëse dhe bazuar në dokumente përfundimtare zyrtare, që d.m.th në dokumente të miratuara nga organet përgjegjëse të komunës, të protokoluara dhe me datën përkatëse të protokolimit apo të miratimit, varësisht nga lloji i dokumentit zyrtar.
- Bashkërendon dhe bashkëpunon me përgjegjësitë e njësisë përkatëse ku punon dhe prej ku i merr të dhënat dhe me KKP.

- Raporton të dhënat e verifikuara tek KKP, në kopje fizike, kur kjo nuk bëhet në mënyrë automatike nga program elektronik i SMPK. Është përgjegjësi kryesor për saktësinë e të dhënave të raportuara në komunë për SMPK.


Neni 4

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet MAPL, Koordinatori komunal për performancë dhe zyrtarët komunal për performancë të cekur më lartë. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për emërimin e koordinatorit komunal të performancës dhe zyrtarëve komunalë për performancë për fushat e caktuara në Komunën e Lipjanit 1 Nr.112-57662 i datës 17.10.2016 dhe Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 1 Nr.112-78953 I datës 19.12.2019.

1Nr. 1-020/02-16384
Lipjan, më 28.03.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 24 të Ligjit Nr.03/L-për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR THEMELIMIN E GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT-PLANIT LOKAL TË
VEPRIMIT NË MJEDIS

Neni 1
Përbërja

Themelohet Grupi punues për hartimin e Draft-Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për Komunën e Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM, Kryesues
2. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspektorat, anëtar
3. Islam Kaleshi Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtar
4. Hanushe Berisha, DPUMM, anëtare
5. Labinot Dedushi, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtar
6. Imri Bytyqi, KRM "Pastrimi" Lipjan, anëtar
7. Bekim Krasniqi, OJQ-YAHR, Lipjan, anëtar
8. Milazim Miftari, Drejtorati për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
9. Selman Jashanica, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
10. Hasan Hajdini, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Grupit punues

Grupi punues ka për detyrë që në pajtim me dispozitat e Ligjit 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit, Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis si dhe dispozitave të tjera përkatëse të hartojë Propozim - Planin Lokal të Veprimit në Mjedis për Komunën e Lipjanit.

Propozim - Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Lipjanit hartohet për periudhën pesë (5) vjeçare 2022 -2027.

Propozim - Plani Lokal i Veprimit në Mjedis duhet të hartohet më së largu me datën 31.08.2022.

Neni 3
Procedimi për miratim i Propozim Planit

Propozim - Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, pas hartimit Grupi punues është i obliguar t'ia dërgojë Kryetarit të Komunës për aprovim paraprak e pastaj Propozim – Plani do të vëhet në diskutim publik.

Organizimin e diskutimit publik do ta bëjë Grupi punues i themeluar me këtë Vendim dhe pas mbylljes së fazës së konsultimit publik Propozim Plani nëpërmjet Zyrës së Kryetarit të Komunës do të procedohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

Neni 4
Mbështetja profesionale dhe teknike

Grupit Punues sipas nevojës i ofrojnë të dhënat e kërkuara dhe mbështetje tjetër profesionale drejtoratet e caktuara në kuadër të Komunës.

Punët administrativo teknike për grupin punues do t'i kryej Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

01 Nr. 020/oh-16928
Lipjan, më 31.03.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 15 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr. 03/2020 për transparencë në Komuna, nenit 16 të Rregullores për transparencë në Komunën e Lipjanit 15Nr.353-35739 të datës 30.06.2021 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR
TRANSPARENÇË

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për hartimin e planit të veprimit për transparencë, (në vazhdim të tekstit Komisioni) në përbërje si vijon:

1. Bukuriye Zejnullahu-Jashari, Shefe e Sektorit për Mardhënie me Publikun, Kryesuese,
2. Burim Gashi, Shef i Sektorit për Administratë të Përgjithshëm, anëtar
3. Qendresa Jashanica-Dërmaku, Zyrtare për Informim, anëtare
4. Besart Troshupa, Zyrtar për Informim, anëtar
5. Valdete Muji, Zyrtare Ligjore, anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë që të hartoj Planin e veprimit për transparencë në Komunë duke u bazuar në dispozitat ligjore përkatëse në fuqi komisioni duhet të përfundoj punën më së largu deri më datë 22.04.2022.


Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-15135
Lipjan, më 21.03.2022

KRYETARI KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për projektet të OJQ-ve (klubet sportive) që veprojnë në Komunën e Lipjanit për vitin 2022, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Islam Sylejmani, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Ronita Bahtiri, nga OJQ-të, anëtar
5. Fidan Tmava, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit, anëtar
6. Linda Shahini, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare rezerv

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për OJQ (Klubet Sportive) që veprojnë në Komunën e Lipjanit, që kanë aplikuar konform Thirrjes publike për aplikim Nr.1-400-7857 të datës 09.02.2022, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Hyrja në fuqi

1. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.453/01-14747 i datës 17.03.2022.

1Nr. 020-15360
Lipjan, më 22.03.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për projektet të OJQ-ve (klubet sportive) që veprojnë në Komunën e Lipjanit për vitin 2022, në përbërje si vijon:

1. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Islam Sylejmani, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Ronita Bahtiri, nga OJQ-të, anëtar
5. Fidan Tmava, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit, anëtar
6. Linda Shahini, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare rezerv

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për OJQ (Klubet Sportive) që veprojnë në Komunën e Lipjanit, që kanë aplikuar konform Thirrjes publike për aplikim Nr.1-400-7857 të datës 09.02.2022, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 01-453/01-14747
Lipjan, më 17.03.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Kërkesën e Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të datës 09.03.2022, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për dhënien e vlerësimit profesional për largimin e drunjëve të tharë nga sheshi i qytetit apo rrugët tjera publike në kuadër të territorit të komunës , në këtë përbërje:

1. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspektorat, Kryesues
2. Azem Arifi, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
3. Enver Elshani, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë verifikimin e drunjëve të tharë në gjithë territorin e Komunës dhe të jap vlerësimin profesional se a duhet të largohen –prehen drunjët e thatë për shkak të vjetërsisë dhe se a paraqesin rrezik për kalimtarët sa herë që do të jetë e nevojshme varësisht nga nevojat dhe kërkesat e komunës apo kërkesat e parashtruara nga qytetarët për shkaqe të arsyeshme.
2. Komisioni ka mandat një vjeçar dhe për punën e tij e raporton Kryetarit të Komunës.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe më të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Inspeksion, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural , Drejtorati për Shërbime Publike ,Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.


1Nr.320-11802
Lipjan, më 11.03.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullores (QRK)- NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, udhëzuesit për zbatimin e Rregullores, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR KTHIM

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni komunal për kthim, në përbërje:

1. Zoran Stojanovic, ZKKK - kryesuesë
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Rozeta Selimi, DSHPS, anëtare
4. Lorik Bërbatovci, Zyrtar në QPS, anëtar
5. Rafete Retkoceri, DSHP, anëtare
6. Hana Berisha, DPUMM, anëtare
7. Ilir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
8. Një përfaqesues nga MKK-ja, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit komunal për kthim

Komisioni komunal për kthim do të kryejë detyrat në bazë të dispozitave të Rregullores (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme si dhe udhëzuesit për zbatimin e Rregullores.
Mandati i Komisionit është 3 vjeçar me mundësi vazhdimi edhe për një mandatë shtesë.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njëjtin kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/oh-16922
Lipjan, më 30.03.2022

